

V E N D I M
Nr.85, datë 29.3.2002

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO VENDORE PRIVATE “BOOM BOOM”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “BOOM BOOM RADIO-TV” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, shoqëria “Boom Boom Radio - TV” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.